



BASHKIA MIRDITË

Nr. 2807 Prot.

Rrëshen, më 15 .07 .2024

Lënda: Dëgjesa publike mbi ndërmarrjen e Nismës për Rishikimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Mirditë me procedurë të thjeshtuar

PËR INFORMIM PUBLIK

Adresa për publikim: 1) Faqja zyrtare e bashkisë Mirditë;
2) Në RKPT;
3) Afishim në hollin e bashkisë Mirditë
4) Palët e interesuara, që kanë paraqitur kërkesa për rishikime, njoftohen me telefon ose email.

Për dijëni: Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKPT)
Drejtoreshës së Përgjithshme Znj. Adelina GRECA,

Adresa: Rruga "Muhamet Gjollësja", ndërtesa 70, hyrja 1, TIRANË

Të nderuar qytetarë,

Referuar Ligjit 107/204 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, Ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 686, datë 22.11.2017 "Për Miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", me të gjitha ndryshimet; kërkesave të qytetarëve dhe kërkesave të vetë bashkisë; ju informojmë që bashkia Mirditë ka ndërmarrë hapat për Rishikimin e Planit të Përgjithshëm Vendor me procedurë të thjeshtuar.

Për sa më sipër, bazuar në pikën 5 të Udhëzimit Nr. 1, datë 06.12.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të AKPT-së "Për hartimin, bashkërendimin, miratimin dhe kontrollin e procesit të rishikimit të dokumentave të planeve të përgjithshme vendore me procedurë të thjeshtuar" i ndryshuar,

NJOFTOJ organizimin e dëgjesës publike në adresën: "Pallati i Kulturës Rrëshen" me datë 26.07.2024, Ora 11:00.

Duke ju falenderuar, jeni të mirëpritur në takim.

Publikojmë bashkëlidhur edhe:

1. Vendimin Nr. 20, me Nr. 1345/4 Prot, datë 30.05.2024 të Kryetarit "Për marrjen e nismës për rishikimin e dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Mirditë", me procedurë të thjeshtuar.

2. Urdhërin Nr. 219, me Nr. 1345/5 Prot, datë 31.05.2024 “Për ngritjen e grupit të punës për rishikimin e Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV-së) të Bashkisë Mirditë”.
3. Nismën e rishikuar, të Miratuar nga Kryetari i Bashkisë, me Nr. 1345/6 Prot, datë 05.06.2024.

Akte të cilat janë dërguar pranë AKPT-së dhe janë publikuar në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit (**RKPT**)

KRYETARI
Albert MËLYSHI





BASHKIA MIRDITË

Nr. 2315 Prot.

Rrëshen, me 07.06.2024

Lënda: Dërgim dokumentacioni mbi ndërmarrjen e Nismës për Rishikimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Mirditë

AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT (AKPT)

Drejtoreshës së Përgjithshme Znj. Adelina GRECA,

Adresa: Rruga "Muhamet Gjollësja", ndërtesa 70, hyrja 1, TIRANË

E nderuar Znj. GRECA!

Referuar Ligjit 107/204 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, Ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 686, datë 22.11.2017 "Për Miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", me të gjitha ndryshimet, kërkesave të qytetarëve të protokolluara në Bashkinë Mirditë dhe dokumentacionit bashkëlidhur, ju informojmë që Bashkia Mirditë ka ndërmarrë hapat për Rishikimin e Planit të Përgjithshëm Vendor.

Për sa më sipër, bashkëlidhur ju dërgojmë:

1. Vendimin Nr. 20, me Nr. 1345/4 Prot, datë 30.05.2024 të Kryetarit "Për marrjen e nismës për rishikimin e dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Mirditë".
2. Urdhërin Nr. 219, me Nr. 1345/5 Prot, datë 31.05.2024 "Për ngritjen e grupit të punës për rishikimin e Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV-së) të Bashkisë Mirditë".
3. Nismën e rishikuar, të Miratuar nga Kryetari i Bashkisë, me Nr. 1345/6 Prot, datë 05.06.2024.
4. Informacionin e marrë nga DAMT gjatë hartimit fillestar të PPV-së, me shkresat e bashkisë Mirditë Nr. 3446 Prot., datë 28.07.2017 dhe kthim përgjigjen nga Këshilli i Qarkut Lezhë (DAMT) me Nr. 1403/1 Prot., datë 30.08.2017.

Theksojmë se aktet e sipërcituara janë hartuar e rishikuar për tu përpunuar me rekomandimet dhe udhëzimet e dhëna nga drejtuesit dhe specialistët e AKPT-së në takimin me ta, me shkresën tuaj Nr. 296/01 Prot. datë 20.03.2024 dhe me komunikimet elektronike me email, deri sa kanë marrë formën përfundimtare aktuale.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETARI
Albert MËLYSHI



ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRËSHEN

email: bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax: (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al



**BASHKIA MIRDITË
KRYETARI**

Nr. 1345/Prot.

Rrëshen, me 30.05.2024

VENDIM

Nr. 20, Datë 30.05.2024

PËR

**MARRJEN E NISMËS PËR RISHIKIMIN E DOKUMENTIT TË PLANIT TË PËRGJITHSHËM
VENDOR, BASHKIA MIRDITË**

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, në nenin 13, pika 1, shkronja “b”, në nenin 26 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, në nenin 11 dhe 12 të VKM-së Nr. 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”, e ndryshuar,

VENDOSA:

1. Të ndërmarrë nismën për rishikimin e dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor me procedurë të thjeshtuar, për ato çështje dhe kërkesa të cilat:
 - a. Janë në përputhje dhe nuk bien në kundërshtim me legjislacionin sektorial në fushën e mjedisit, zonave të mbrojtura, trashëgiminë historike e kulturore;
 - b. Janë në përputhje, nuk bien në kundërshtim dhe nuk ndryshojnë dokumentin e Strategjisë Territoriale;
 - c. Vijnë si pasojë e konstatimit të gabimeve e mospërputhjeve në dokumentin e planit dhe mes pjesëve përbërëse të tij, mes planit e gjendjes faktike në territor dhe kërkesave të pronarëve që kërkojnë zhvillimin e pronës së tyre.
 - d. Vijnë si pasojë e forcave madhore, si: tërmete, përmbytje, zjarre masive, rrëshqitje të tokës, erozion, etj. të ngjashme, për shkak të ndarjeve administrative e territoriale, ndryshimeve të paparashikuara demografike, sociale e ekonomike, ndryshimeve të shkaktuara nga kriza sektoriale;
 - e. Vijnë si nevojë për harmonizimin me dokumente të një niveli më të lartë planifikimi apo me ndryshime të kuadrit ligjor në fushën e mbrojtjes e të menaxhimit të territorit, si dhe për arsye të përafritimit me legjislacionin e Bashkimit Evropian.
2. Për zbatimin e këtij vendimi dhe ndjekjen e procedurave në vijim ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë Mirditë.
3. Dokumenti i Nismës do të bëhet pjesë integrale e këtij vendimi.
4. Vendimet nr. 11, nr. 949/1 prot., datë 07.03.2024 dhe nr. 18, nr. 1345/2 prot., datë 24.04.2024 shfuqizohen dhe zëvendësohen nga ky vendim.
5. Vendimi për marrjen e Nismës dhe dokumenti i Nismës botohen në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit.

**KRYETARI
Albert MËLYSHI**



ADRESA: SHESHI “ABAT DOÇI”, RRËSHEN

email: bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax: (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al



BASHKIA MIRDITË

Nr. 1345/Prot.
15

Rrëshen, me 31.05.2024

URDHËR

NR. 219, DATË 31.05.2024

“PËR NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS PËR RISHIKIMIN E PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR (PPV-së) TË BASHKISË MIRDITË”

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenet 15, 16, 59, 60 dhe 64 gërma a) të Ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, neni 8 gërma c), neni 12 pika 2 të Ligjit “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, nenit 3, 11 dhe 12 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 02, datë 20.06.2018 “Për Miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor bashkia Mirditë” i rishikuar me vendimet nr. 09, datë 14.10.2020 dhe nr. 02, datë 08.03.2023, të Udhëzimit Nr. 1, datë 06.12.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të AKPT-së “Për hartimin, bashkërendimin, miratimin dhe kontrollin e procesit të rishikimit të dokumenteve të planeve të përgjithshme vendore me procedurë të thjeshtuar” i ndryshuar, të shkresës së Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKPT) nr. 296/01 prot., datë 20.03.2024, e protokolluar në bashkinë Mirditë me nr. 1192, datë 25.03.2024 e sugjerimeve të tjera të saj në rrugë e lektronike, si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore që rregullojnë Planifikimin e Territorit, të kërkesave të qytetarëve të interesuar, të protokolluara pranë bashkisë Mirditë si dhe pas vendimit të kryetarit të bashkisë Nr. 20, Nr. 1345/4 Prot., datë 30.05.2024,

URDHËROJ:

A. NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS PËR RISHIKIMIN E PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR (PPV-së) TË BASHKISË MIRDITË

Komisioni të përbëhet nga anëtarët si vijon:

1. Aleksandër PICAKU - Kryetar, me funksion Kryetar i Këshillit bashkiak,
2. Gjergj PRENGA - Anëtar, me funksion Nënkryetar i bashkisë,
3. Administratorët e të gjitha njësive administrative të bashkisë - Anëtar,
4. Genc VLADI - Anëtar, me funksion Drejtor i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit
5. Besian DEDAJ - Anëtar, me funksion Drejtor Juridik,
6. Vjollca GJOKA - Anëtare, me funksion Drejtor i Zhvillimit Ekonomik dhe Tatim Taksave
7. Julian VLASHI - Anëtar, me funksion Drejtor i Trashëgimisë Kulturore dhe Turizmit,
8. Frederik VORFI - Anëtar, me funksion Drejtor i AIKE,
9. Kastriot BICA - Anëtar, me funksion Drejtor i B.U dhe Administrimit të Pyjeve,
10. Aurel ÇUPI - Anëtar, me funksion Drejtor i Arsimit, Sportit dhe N.S,
11. Arjel MARKU - Anëtar, me funksion Drejtor i Agjencisë Rrugëve;
12. Dianisa TRYCI - Anëtare, me funksion p/sectorit Planifikimit të Territorit dhe H.P.M.I.P
13. Adenis DEDAJ - Anëtar, me funksion Specialist inxhinier gjeodet dhe GIS
14. Zef MARGJINI - Anëtar, me funksion Inspektor Mjedisi dhe Pyje
15. Lorena GJERGJI - Anëtare, me funksion Specialist Juriste

ADRESA: SHESHI “ABAT DOÇI”, RRËSHEN

email: bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax: (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al

- B.** Grupi i punës do të marrë në konsideratë dhe shqyrtojë kërkesat e ardhura në adresë të bashkisë Mirditë, të cilat lidhen me ndryshimin/rishikimin e PPV-së.
- C.** Do të shqyrtojë dhe do të propozojë rishikimin e mospërputhjeve midis pjesëve të ndryshme të PPV-së, të kërkuara në kërkesat e protokolluara pranë bashkisë Mirditë, dhe do të përgatisë relacionin përkatës (nismën e rishikuar sipas akteve ligjore dhe udhëzimeve të AKPT-së të dhëna në shkresën nr. 296/01 prot., datë 20.03.2024, të dhëna në rrugë elektronike e që do të jepen në vazhdimësi) me propozimet për rishikim.
- D.** Urdhërat nr. 47, nr. 564 prot., datë 09.02.2024 dhe nr. 118, nr. 1345 prot., datë 03.04.2024 shfuqizohen dhe zëvendësohen nga ky urdhër.
- E.** Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Albert MËLYSHI



ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRËSHEN

email: bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax: (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al



BASHKIA MIRDITË

Nr. 1345/Prot.

6

Rrëshen, më 05.06.2024

NISMA

PËR RISHIKIMIN E PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR (PPV-së) BASHKIA MIRDITË

(me procedurë të thjeshtuar)

Rishikuar me 05 Qershor 2024

**MIRATOHET
KRYETARI
Albert MËLYSHI**



RRËSHEN 2024

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRËSHEN

email: bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax: (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al

TABELA E PËRMBAJTJES



HYRJE	3
BAZA LIGJORE	3
QËLLIMI DHE NEVOJA PËR RISHIKIM TË DOKUMENTIT TË PLANIFIKIMIT	5
2. DOKUMENTET, PJESË E PPV-së, TË CILAT DO TI NËNSHTROHEN RISHIKIMIT	7
3. EKSPERTËT (FUSHAT E EKSPERTIZËS) QË DO TË PËRBËJNË GRUPIN E PUNËS QË DO TË RISHIKOJNË PPV-NË	7
4. PËRCAKTIME PËR PROÇESIN E BASHKËRENDIMIT, KËSHILLIMIT DHE TAKIMEVE PUBLIKE	9
5. PLANI I VEPRIMIT PËR RISHIKIMIN E DOKUMENTIT TË PLANIFIKIMIT	9
6. PEZULLIMI I ZHVILLIMEVE NË TERRITORIN ADMINISTRATIV TË BASHKISË	10

HYRJE

Bashkia Mirditë ndodhet në Shqipërinë Veriore. Ajo përbëhet nga 7 (shtatë) Njësi Administrative, respektivisht: Njësia Administrative Rrëshen, Rubik, Kthellë, Selitë, Orosh, Fan dhe Kaçinar. Bashkia ka një sipërfaqe prej 867,1 km² dhe një popullsi të regjistruar në gjendjen civile prej 37 384 banorë.

Karakteristikat gjeografike/territoriale:

Bashkia Mirditë gjendet midis koordinatave gjeografike 41° 43' e 41° 59' gjerësi veriore dhe 19° 43' e 20° e 12' gjatësi lindore, duke u kufizuar në veri me bashkitë e Fushë Arrësit dhe Pukës, në perëndim me bashkinë e Lezhës dhe në lindje me bashkinë e Kukësit dhe Dibrës. Në jug-lindje kufizohet me bashkinë Dibër, në jug me bashkinë Mat dhe Kurbin ndërsa në jug-perëndim me bashkinë Kurbin. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Rrëshenit.

Bashkia përfshin 4 qytete dhe 81 fshatra, të shpërndara në 7 njësitë administrative përbërëse të saj: Rrësheni, Rubiku, Selita, Kthella, Fani, Oroshi dhe Kaçinari. Bashkia Mirditë është aktualisht pjesë e qarkut të Lezhës.

Klima është mesdhetare kodrinore, paramalore e malore. Bimësia është mjaft e pasur dhe përbëhet nga shkurre, dushqe, pyje të përzier, ahishte e kullota malore. Bimët mjekësore janë mjaft të përhapura. Nga pikpamja fizike territori karakterizohet nga formacione malore, lugina, pllaja, fusha, fushëgropa.

Lartësia mesatare shkon 557 m mbi nivelin e detit, maja më e lartë është M. Kunorë (Selitë) (Jo Kunora, Mali i Dejës) 2121 m. Përshkohet nga lumenjtë Fani i Madh, Fani i Vogël, Uraka etj. Këta lumenj si dhe përrenj të tjerë malorë, kanë jo vetëm kapacitete prodhuese energjetike por edhe për kultivimin e faunës ujore.

Karakteristikat historike: Aksi rrugor E-851 konsiderohet si boshti kryesor i zhvillimit të bashkisë.

Infrastruktura kryesore e gjendur në bashki është Koridori VII (E-851), e cila nga mbikalimi i Rrëshenit deri në kufirin verilindor të bashkisë (Tuneli i rrugës së kombit Thirrë- Kalimash) ka karakteristikat e autostradës (2 korsi për secilin drejtim dhe trafikndarës, ndërsa pjesa e mbetur është rrugë e gjerë me një korsi për secilin drejtim dhe pa trafikndarës.

Rruga SH-30 është aksi rrugor kryesor i rrugës kombëtare të vjetër që përshkon bashkinë, para ndërtimit të rrugës së lartpërmendur dhe ka një shtrirje paralele me Koridorin VII deri në Blinisht, ku ndryshon drejtim, duke shkuar në veri për në bashkinë më të afërt, Pukë. Kjo rrugë i ofron akses shumë vendbanimeve. Rruga SH-34 ka drejtim nga qyteti i Rrëshenit drejt Qarkut Dibër (Burrel dhe Lurë), duke lidhur qendrën e bashkisë me njësitë administrative Selitë dhe Kthellë (vetëm segmenti deri në Përlat Qendër është i asfaltuar ndërsa më tej është në proces rikonstruksioni dhe asfaltimi deri në Lurë e më tej drejt Arras - Peshkopisë).

BAZA LIGJORE

Bashkia Mirditë kërkon të rishikojë dokumentin e planifikimit, për një pjesë të territorit, me procedurë të thjeshtuar, sipas përcaktimeve të neneve 11 dhe 12 të VKM Nr. 686 datë 22.11.2017 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, e ndryshuar.

a. Neni 26, pika 2 e Ligjit Nr.107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, përcakton:

“Planet ndryshohen edhe kur ka ndarje administrative e territoriale, ndryshime të paparashikuara demografike, sociale e ekonomike, ndryshime të shkaktuara nga kriza sektoriale apo nga forca madhore, si dhe në rastet kur lind nevoja e harmonizimit me dokumente të një niveli më të lartë planifikimi apo me ndryshime të kuadrit ligjor në fushën e mbrojtjes e të menaxhimit të territorit si dhe për arsye të përafritimit me legjislacionin e Bashkimit Europian”.

b. Neni 3, pika 1 e VKM Nr. 686 datë 22.11.2017 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, e ndryshuar, përcakton:

“Çdo subjekt i interesuar mund t'i kërkojë autoritetit përgjegjës të planifikimit marrjen e nismës për hartimin e dokumenteve të planifikimit, nëpërmjet një kërkesë drejtuar autoritetit përgjegjës, sipas

përcaktimeve të ligjit dhe kësaj rregulloreje. Gjithashtu, vetë autoriteti përgjegjës i planifikimit mbart detyrimin ligjor të ndërmarrë nisma planifikimi në zbatim të planeve që qëndrojnë më lart në hierarki, sipas përcaktimeve të ligjit apo kur e çmon të nevojshëm rishikimin e dokumenteve ekzistuese të planifikimit”.

Gjithashtu tek ky nen, pika 3, përcakton:

“Palët e interesuara të sektorit publik dhe privat mund të shprehin me shkrim vërejtjet dhe sugjerimet e tyre në lidhje me nismën para miratimit të saj nga autoriteti përgjegjës. Këto vërejtje dhe sugjerime botohen menjëherë në regjistër”

c. Neni 11, pika 3 e VKM Nr. 686 datë 22.11.2017 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, e ndryshuar, përcakton:

“Në disa raste, procesi i rishikimit të dokumentit të planifikimit realizohet duke ndjekur një procedurë të thjeshtuar, e cila ka për qëllim të shkurtojë afatet e procesit të planifikimit, këshillimit e të bashkërendimit, të përjashtojë miratimin e nismës dhe të trajtojë vetëm pjesët e dokumentit të planifikimit, subjekt rishikimi, në varësi të rastit dhe nevojave”

Procedura e thjeshtuar ndiqet kur rishikimi i dokumentit të planifikimit bëhet për një pjesë të territorit dhe përmbushen kriteret e mëposhtme:

a) Dokumentet e planifikimit ndryshohen për çështje që nuk çenojnë vlerat natyrore e mjedisore, zonat e mbrojtura dhe trashëgiminë historike e kulturore;

b) Rishikimi nuk shoqërohet me ndryshime të strategjisë territoriale;

c) Sipas pikës 2 të nenit 26 të ligjit.

Referuar nenit 12, pika 1 të VKM Nr. 686/2017, Dokumenti i nismës për hartimin e PPV-së, përmban:

a) hartimin e dokumentit të Nismës për rishikimin e pjesshëm të dokumentit përkatës të planifikimit, duke specifikuar:

i. qëllimin dhe nevojën e rishikimit të planit;

ii. dokumentet apo pjesët përbërëse të tyre, subjekt rishikimi;

iii. ekspertët që do të përbëjnë grupin e punës për rishikimin e dokumentit;

iv. përcaktime për procesin e bashkërendimit, këshillimit dhe takimeve publike duke specifikuar afatet;

v. planin e veprimeve për rishikimin e dokumentit;

vi. sipas rastit, vendimin për pezullimin e zhvillimit për të gjithë, ose një pjesë të territorit subjekt rishikimi, sipas nenit 33 të Ligjit, shoqëruar me hartën përkatëse.

b) këshillimin e projekt dokumentit të nismës me Agjencinë dhe publikun nëpërmjet Regjistrit Kombëtar të Planifikimit të Territorit;

c) botimin e dokumentit përfundimtar të nismës, me reflektimet përkatëse në rast të komenteve, shoqëruar me vendimin e autoritetit përgjegjës për hartimin e dokumentit të planifikimit për ndërmarrjen e nismës.

Proçesi i rishikimit të PPV-së do të bazohet në **Ligjin Nr. 107/2014** “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, **VKM-në Nr. 686, datë 22.11.2017** “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, e ndryshuar, **Udhëzimin Nr. 1, datë 06.12.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të AKPT-së** “Për hartimin, bashkërendimin, miratimin dhe kontrollin e procesit të rishikimit të dokumenteve të planeve të përgjithshme vendore me procedurë të thjeshtuar”, **Udhëzimin Nr. 47, datë 11.05.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të AKPT-së** “Për një shtesë të udhëzimit Nr. 1, datë 06.12.2021 për hartimin, bashkërendimin, miratimin dhe kontrollin e procesit të rishikimit të dokumenteve të planeve të përgjithshme vendore me procedurë të thjeshtuar”, në shkresën e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKPT) Nr. 296/01 Prot., datë 20.03.2024, e protokolluar në bashkinë Mirditë me Nr. 1192, datë 25.03.2024 si edhe legjislacionin sektorial në fuqi. Po sipas përcaktimeve ligjore, autoriteti përgjegjës për rishikimin e PPV-së është kryetari i bashkisë. Dokumenti do të hartohet në bashkërendim dhe këshillim me Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit.

1. QËLLIMI DHE NEVOJA PËR RISHIKIM TË DOKUMENTIT TË PLANIFIKIMIT

Me Vendimin Nr. 2 datë 20.06.2018 Këshilli Kombëtar i Territorit ka miratuar Planin e Përgjithshëm Vëndor të bashkisë Mirditë. Gjatë periudhës së zbatimit të tij, bashkia ka evidentuar disa vështirësi në zbatimin e këtij dokumenti të listuara si më poshtë:

- a. Mungesa e gjurmëve ndërtimore në zona të caktuara për ndërtime sipas kërkesave të subjekteve/qytetarëve të interesuar, që kanë dokumenta që i lidhin ato me pronat përkatëse, dhe të vetë bashkisë.
- b. Nevoja për rritje të koeficientit të shfrytëzimit të truallit për parcelat publike dhe private.

Arsyet për ndërmarrjen e nismës për rishikimin e Planit, lidhen kryesisht me:

Kërkesat e subjekteve/qytetarëve të interesuar, që kanë dokumenta që i lidhin ato me pronat përkatëse, dhe duan ti zhvillojnë por që për këtë, dhe idetë e tyre për zhvillim, duhet rishikuar pjesërisht PPV-ja.

Përfshirjen në plan të dy pronave në pronësi të bashkisë Mirditë për zhvillim dhe ndërtim të Institucioneve të Shërbimit Publik (stacion zjarrfikës).

Mbështetur dhe në rezultatet e analizave të mësipërme, PPV e rishikuar do të zgjidhë problematika që lidhen me ndryshimin e Njësive strukturore si vijon:

1. Njësia strukturore me kodin MR_UB_IS6_114/1, **aktualisht** me Sistem UB_Urban, me Kategori 1 IS - Institucione 100%, me Nënkategori 1 IS.6 Institucione Fetare, **duke e ndryshuar pjesërisht** në Sistem UB_Urban, me Kategori 1, në A. Banim 85% dhe Kategoria 2 S.Shërbime 15%, numri i kateve në 9, me lartësi maksimale 29 m.

Përfshirja në procedurat e rishikimit të PPV-së, kërkuar me shkresën e protokolluar pranë bashkisë Mirditë me Nr. 2133, datë 08.06.2023. Kërkuesi ka paraqitur edhe dokumentat që e lidhin atë me pronën përkatëse, njësia strukturore e të cilës është kërkuar për ndryshim të pjesshëm sipas sipërfaqes dhe htr në certifikatën e pronësisë.

2. Njësia strukturore me kodin MR_B_BA1_272/1, **aktualisht** me Sistem B_Bujqësor, me Kategori 1 BA. Bujqësi dhe Banim 20% dhe Kategori 2 EB. Ekonomi Bujqesore 80%, **duke e ndryshuar pjesërisht** në Sistem UB_Urban, Kategoria 1, S.Shërbime 100%, N/Kategoria 1 S.1 Shërbime akomodimi dhe argëtimi dhe N/Kategoria 2 S.2 Shërbime Tregtare dhe Biznesi.

Balli mesatar i Bonitetit të tokës, për fshatin Fierzë, ku shtrihet njësia strukturore, është 5. Kjo e bazuar në informacionin e marrë nga DAMT gjatë hartimit fillestar të PPV-së, me shkresat e bashkisë Mirditë Nr. 3446 Prot., datë 28.07.2017 dhe kthim përgjigjen nga Këshilli i Qarkut Lezhë (DAMT) me Nr. 1403/1 Prot., datë 30.08.2017. E dhëna mbi bonitetin e tokës në përgjigje të shkresës të Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKPT) Nr. 296/01 Prot., datë 20.03.2024, e protokolluar në bashkinë Mirditë me Nr. 1192, datë 25.03.2024.

Përfshirja në procedurat e rishikimit të PPV-së, kërkuar me shkresën e protokolluar pranë bashkisë Mirditë me Nr. 4902, datë 29.12.2023. Kërkuesi ka paraqitur edhe dokumentat që e lidhin atë me pronën përkatëse, njësia strukturore e të cilës është kërkuar për ndryshim të pjesshëm sipas sipërfaqes dhe htr në certifikatën e pronësisë.

3. Njësia strukturore me kodin MR_UB_A2_131/9, **aktualisht** me Sistem UB_Urban, me Kategori 1 A. Banim 80% Kategori 2 S.Shërbime 20%, **duke e ndryshuar pjesërisht**, zgjeruar dhe marrë sipërfaqe nga rruga me kodin MR_IN_INT1_131/7 (që aktualisht në hyrje është me gjërësi 4 m dhe vjen e zgjerohet deri në 7.2 m, duke e ndryshuar, uniformëzuar, në të gjithë gjatësinë e saj me gjërësi 4m), si dhe ndryshuar treguesit e zhvillimit duke e planifikuar po në Sistem UB_Urban, por me Kategori 1 A. Banim 40%, Kategori 2 S.Shërbime 30% dhe Kategori 3 IE. Industri dhe Ekonomi 30%, me N/Kategori 1 A.2 Banim dhe Shërbime, N/Kategori 2 S.1 Shërbime Akomodimi dhe Argëtimi, N/Kategori 3 IE.1 Industri e Lehtë dhe N/Kategori 4 S2-Shërbime Tregtare dhe Biznesi.

Përfshirja në procedurat e rishikimit të PPV-së, kërkuar me shkresën e protokolluar pranë bashkisë Mirditë me Nr. 218, datë 17.01.2024. Kërkuesi ka paraqitur edhe dokumentat që e lidhin atë me pronën

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRËSHEN

përkatëse, njësia strukturore e të cilës është kërkuar për ndryshim të pjesshëm sipas sipërfaqes dhe htr në certifikatën e pronësisë.

4. Njësia strukturore me kodin MR_UB_IE3_114/1, **aktualisht** me Sistem UB_Urban, me Kategori 1 IE.Industri dhe Ekonomi 80% dhe S.Sherbime 20%, **duke e ndryshuar pjesërisht** në Sistem UB_Urban, Kategoria 1 A. Banim 80% dhe Kategori 2 S.Shërbime 20%, me N/Kategori 1 A.2 Banim dhe Shërbime, N/Kategori 2 S.1 Shërbime Akomodimi dhe Argëtimi dhe N/Kategori 3 S2-Shërbime Tregtare dhe Biznesi.

Përfshirja në procedurat e rishikimit të PPV-së, kërkuar me shkresën e protokolluar pranë bashkisë Mirditë me Nr. 1074, datë 13.03.2024. Kërkuesi ka paraqitur edhe dokumentat që e lidhin atë me pronën përkatëse, njësia strukturore e të cilës është kërkuar për ndryshim të pjesshëm sipas sipërfaqes dhe htr në certifikatën e pronësisë.

5. Njësia strukturore me kodin MR_B_B2_542/1, **aktualisht** me Sistem B_Bujqësor, me Kategori 1 B. Tokë Bujqësore 60% dhe Kategori 2 EB.Ekonomi Bujqesore 40%, **duke e ndryshuar pjesërisht** në Sistem UB_Urban, me Kategori 1 A. Banim 80% dhe Kategori 2 S.Shërbime 20%, me N/Kategori 1 A.2 Banim dhe Shërbime, N/Kategori 2 S.1 Shërbime Akomodimi dhe Argëtimi dhe N/Kategori 3 S2-Shërbime Tregtare dhe Biznesi.

Balli mesatar i Bonitetit të tokës, për fshatin Fush-Lumth, ku shtrihet njësia strukturore, është 5. Kjo e bazuar në informacionin e marrë nga DAMT gjatë hartimit fillestar të PPV-së, me shkresat e bashkisë Mirditë Nr. 3446 Prot., datë 28.07.2017 dhe kthim përgjigjen nga Këshilli i Qarkut Lezhë (DAMT) me Nr. 1403/1 Prot., datë 30.08.2017. E dhëna mbi bonitetin e tokës në përgjigje të shkresës të Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKPT) Nr. 296/01 Prot., datë 20.03.2024, e protokolluar në bashkinë Mirditë me Nr. 1192, datë 25.03.2024.

Përfshirja në procedurat e rishikimit të PPV-së, kërkuar me shkresën e protokolluar pranë bashkisë Mirditë me Nr. 1081, datë 13.03.2024. Kërkuesi ka paraqitur edhe dokumentat që e lidhin atë me pronën përkatëse, njësia strukturore e të cilës është kërkuar për ndryshim të pjesshëm sipas sipërfaqes dhe htr në certifikatën e pronësisë.

6. 6.1-Njësia strukturore me kodin MR_UB_S1_107/5, **aktualisht** me Sistem UB_Urban, Kategoria 1 S.Shërbime 100% **duke e ndryshuar pjesërisht** në Sistem UB_Urban, Kategoria 1 IS. Institucione 100%, me N/Kategori 1 IS.2_Institucione të Shërbimit Publik. 6.2-Për njësinë strukturore me kodin MR_UB_A2_114/39 (zona e re zhvillimore Rrëshen), **kërkohet të rishikohet** vetëm numri maksimal i kateve, nga 3 kate në 4 kate, dhe lartësia, nga 11 m në 15 m.

Përfshirja në procedurat e rishikimit si nevojë e vetë bashkisë Mirditë, për të bërë të mundur ndërtimin e stacionit zjarfikës dhe katër pallateve katër katëshe me përfitues bashkinë Mirditë. Kërkuesi, vetë bashkia, paraqet edhe dokumentat që e lidhin atë me pronën përkatëse, njësia strukturore e të cilës është kërkuar për ndryshim të pjesshëm sipas sipërfaqes dhe htr në certifikatën e pronësisë.

7. Gjatë periudhës, që nga marrja e nismës, deri sot, që bëhet rishikimi i dytë i saj, janë shqyrtuar disa kërkesa për rishikimin e planit të përgjithshëm vendor dhe konkretisht:

7.1 Kërkesa, e protokolluar pranë bashkisë Mirditë me Nr. 724, datë 19.02.2024, ka marrë përgjigje me shkresën Nr. 724/1 Prot., datë 04.04.2024.

7.2 Kërkesa, e protokolluar pranë bashkisë Mirditë me Nr. 751, datë 20.02.2024, ka marrë përgjigje me shkresën Nr. 751/1 Prot., datë 04.04.2024.

7.3 Kërkesa, e protokolluar pranë bashkisë Mirditë me Nr. 1178, datë 21.03.2024, ka marrë përgjigje me shkresën Nr. 1178/1 Prot., datë 27.03.2024.

7.4 Kërkesa, e protokolluar pranë bashkisë Mirditë me Nr. 1179, datë 21.03.2024, ka marrë përgjigje me shkresën Nr. 1179/1 Prot., datë 27.03.2024.

Në thelb të këtyre katër kërkesave ka qënë rishikimi i një pjese të një njësie strukturore të planit të përgjithshëm vendor (PPV-së) për të mundësuar zhvillimin e një sipërfaqeje të caktuar që ndodhet në

njësi strukturore me sistem Natyror (N).

Të gjitha këtyre kërkesave ju ka munguar dokumentacioni vërtetues, që lidh kërkesin me pronën, njësia strukturore e së cilës kërkohej të ndryshohej.

Pavarësisht kësaj, kryesisht, objektin e këtyre 4 kërkesave KKT-ja e ka zgjidhur me vendimin e saj Nr. 12, datë 27.02.2019 "Për miratimin e lejeve të Zhvillimit/Ndërtimit nga autoritetet e zhvillimit të territorit, në njësitë që i përkasin sistemeve urban (UB), bujqësor (B) dhe natyror (N)". Kjo vetëm për objektet/strukturat e cituara në këtë vendim si edhe sipas kushteve të tij. Prandaj këto kërkesa konsiderohen të shqyrtuara pasi pajisja me leje zhvillimi/ndërtimi, për një kategori objektsh, që përfshihen në vendimin e KKT-së Nr. 12, datë 27.02.2019, e që kryesisht kanë qënë edhe objekt i këtyre kërkesave, lejohet pa qënë i nevojshëm ndryshimi i PPV-së.

7.5 Kërkesa, e protokolluar pranë bashkisë Mirditë me Nr. 1080, datë 13.03.2024, vetë kërkuesi, ka kërkuar mos shqyrtimin e saj me shkresën e protokolluar po pranë bashkisë Mirditë me Nr. 1080/1, datë 04.04.2024.

Nisma është ndërmarrë me vendimin e kryetarit të bashkisë Nr. 20, Nr. 1345/4 Prot., datë 30.05.2024. Komisioni/Grupi i punës është ngritur e rishikuar nga Kryetari i bashkisë me Urdhërin e fundit Nr. 219, Nr. 1345/5 Prot., datë 31.05.2024. Kjo nisëm është në vijim të nismës Nr. 949 Prot., datë 04.03.2024 dhe Nr. 1345/1 Prot., datë 12.04.2024 duke i rishikuar/zevendësuar ato, pas sugjerimeve në rrugë shkresore dhe elektronike të Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, e duke marrë formën përfundimtare si ky dokument.

Grupi i punës ka analizuar me vëmendje planin dhe ka njoftuar kryetarin e bashkisë për çështjet e evidentuara në Planin e Përgjithshëm Vendor, të cilat nevojitet të rishikohen, bazuar në kërkesat përkatëse të sipërcituara, dhe i ka propozuar për rishikimin e këtij plani, me qëllim ndryshimin e Njësive strukturore të sipërcituara dhe vijimin e procedurave të mëtejshme për çdo propozim të mundshëm që do të shprehen edhe në dëgjesën publike që do të realizohet, si dhe rishikimin në disa pjesë të veçanta për interes zhvillimi të bashkisë Mirditë dhe enteve të tjera publike, nëse do ketë.

2. DOKUMENTET, PJESE E PPV-së, TË CILAT DO TI NËNSHTROHEN RISHIKIMIT

Bazuar në analizën e dokumentit të planifikimit në fuqi si dhe bazuar në sa më sipër, është evidentuar që dokumentet që do të preken nga procesi i rishikimit të PPV-së janë:

- a. Rregullorja e Planit të Përgjithshëm Vendor.
- b. Tabela e treguesve të zhvillimit të Njësive strukturore.
- c. Hartat ilustruese të Njësive strukturore me ndryshime.

Përmbajtja e dokumentit të rishikuar të PPV-së do të bazohet në VKM Nr. 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", dhe udhëzimeve të nxjerra nga AKPT, konkretisht do të përmbajë:

- Dokumentin e rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, ku jepen:

- a) ndërhyrjet në nenet e Rregullores vendore të Planit;
- b) ndërhyrje në pasaportat e njësive strukturore;
- c) etj, sipas analizimit të detajuar të Planit të Përgjithshëm Vendor.

- Shtojcat përkatëse;

- Datamodel GIS me atributet përkatëse.

Dokumentacioni i përgatitur në kuadër të procedurës së rishikimit të PPV-së këshillohet në mënyrë të vazhdueshme me AKPT-në, nëpërmjet postës zyrtare dhe elektronike, takimeve dhe në çdo rast nëpërmjet Rregjistrit Kombëtar të Planifikimit të Territorit (RKPT).

3. EKSPERTËT (FUSHAT E EKSPERTIZËS) QË DO TË PËRBËJNË GRUPIN E PUNËS QË DO TË RISHIKOJNË PPV-NË

Përsa i përket organizimit të strukturave të përfshira në procesin e rishikimit të PPV-së. Dokumenti i

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRËSHEN

email: bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax: (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al

rishikimit të PPV-së do të hartohet nga stafi i bashkisë në bashkërendim dhe bashkëpunim me stafin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit.

Stafi i bashkisë, i cili do të angazhohet në rishikimin e dokumentit të PPV-së, përbëhet nga ekspertë të fushave të ndryshme:

- Të planifikimit të territorit;
- Të ekonomisë dhe financës;
- Të kulturës, historisë;
- Të mjedisit;
- Të fushës juridike, të specializuar në çështje të planifikimit të territorit.

Grupi i punës sipas urdhërit Nr. 47, Nr. 564 Prot., datë 09.02.2024, i ndryshuar, duke shtuar anëtarë, me Urdhërin Nr. 118, Nr. 1345 Prot., datë 03.04.2024, listohet si më poshtë:

1. Aleksandër PICAKU - Kryetar,
Me funksion kryetar i këshillit bashkiak, profesioni Mjek
2. Gjergj PRENGA - Anëtar,
Me funksion nënkryetar i bashkisë, profesioni ushtarak (akademi rendi publik)
3. Administratorët sipas njësive administrative - Anëtarët, si vijon:
 - 3.1 Gjijn MANDREJA - Anëtar,
Administrator njësia administrative Rrëshen, profesioni mësues
 - 3.2 Armando NDOJ - Anëtar,
Administrator njësia administrative Rubik, profesioni shkenca politike
 - 3.3 Vladimir GJKOLAJ - Anëtar,
Administrator njësia administrative Selitë, profesioni-arsim i mesëm
 - 3.4 Gjijn PRENGA - Anëtar,
Administrator njësia administrative Orosh, profesioni-arsim i mesëm
 - 3.5 Astrit DEDAJ - Anëtar,
Administrator njësia administrative Kthellë, profesioni ekonomist
 - 3.6 Armond NDRECA - Anëtar,
Administrator njësia administrative Kaçinar, profesioni-arsim i mesëm
 - 3.7 Edmond GJONAJ - Anëtar,
Administrator njësia administrative Fan, profesioni-arsim i mesëm
4. Genc VLADI - Anëtar,
Me funksion drejtor i drejtorisë planifikimit dhe zhvillimit të territorit, profesioni inxhinier ndërtimi
5. Besian DEDAJ - Anëtar,
Me funksion drejtor i drejtorisë juridike, prokurimeve publike dhe protokollit, profesioni jurist
6. Vjollca GJOKA - Anëtar,
Me funksion drejtor i drejtorisë së zhvillimit ekonomik dhe tatim taksave, profesioni ekonomiste
7. Julian VLASHI - Anëtar,
Me funksion drejtor i drejtorisë së trashëgimisë kulturore dhe turizmit, profesioni historian
8. Frederik VORFI - Anëtar,
me funksion drejtor i agjencisë së inspektimit, kontrollit dhe emergjencave, profesioni jurist
9. Kastriot BICA - Anëtar,
me funksion drejtor i agjencisë së bujqësisë, ujitjes dhe administrimit të pyjeve, profesioni inxhinier pyjesh
10. Aurel ÇUPI - Anëtar,
me funksion drejtor i agjencisë arsimit, sportit dhe ndihmës sociale, profesioni ekonomist
11. Arjel MARKU - Anëtar,
me funksion drejtor i agjencisë rrugëve, profesioni ekonomist
12. Dianisa TRYCI - Anëtar,
me funksion përgjegjëse e sektorit planifikimit të territorit, h. projekteve dhe m.i. publike, profesioni arkitekte
13. Adenis DEDAJ - Anëtar,
me funksion specialist inxhinier gjeodet, profesioni inxhinier gjeodet dhe GIS
14. Zef MARGJINI - Anëtar,
me funksion inspektor mjedisi dhe pyje, profesioni inxhinier mjedisi

15. Lorena GJERGJI - Anëtar,
me funksion specialist juriste, profesioni juriste

Grupi i punës ka marrë e do të marrë në konsideratë kërkesat e ardhura në adresë të bashkisë, të cilat lidhen me zbatimin e PPV-së, do të shqyrtojë dhe do të propozojë rishikimin e mospërputhjeve midis pjesëve të ndryshme të PPV-së si dhe do të përgatisë relacionet përkatëse.

4. PËRCAKTIME PËR PROÇESIN E BASHKËRENDIMIT, KËSHILLIMIT DHE TAKIMEVE PUBLIKE

Gjatë hartimit të dokumentit të rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor është tepër e rëndësishme të sigurohet një proces dialogu, bashkëpunimi dhe bashkërendimi ndërmjet autoriteteve qeverisëse dhe komunitetit, me synim harmonizimin e trajtimit të çështjeve të rëndësishme vendore, të hasura gjatë periudhës së zbatimit të PPV-së.

Sipas përcaktimeve të VKM Nr. 686/2017 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, i ndryshuar, bashkërendimi dhe këshillimi i PPV-së është përgjegjësi e njësisë së qeverisjes vendore dhe parashikohet të kryhet një takim i hapur publik me subjektet/grupet/qtyetarët e interesuar.

Gjatë procesit të rishikimit të PPV-së, nga grupi i punës në bashkëpunim me AKPT do të vlerësohet:

- Nevoja për konsultim me Ministrinë e Turizimit dhe Mjedisit (MTM), për detyrimin ose jo të ndjekjes së procesit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor.*
- Nevoja për bashkërendim me Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM) për ndryshime që mund të propozohen në zonat e banuara brenda Zonave të Mbrojtura.*
- Nevoja për bashkërendim me Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore për ndryshime që mund të jenë në afërsi të monumenteve.*
- Nevoja për bashkërendim me Autoritetin Rrugor Shqiptar dhe Hekurudhën Shqiptare për ndërhyrje që mund të jenë në afërsi të rrugëve nacionale dhe rrjetit hekurudhor.*
- Nevoja për bashkërendim me institucione të tjera publike, sipas propozimeve të bashkisë.*

Grupi i punës ka analizuar dhe do të analizojë e rishikojë çdo kërkesë të ardhur, e që mund të paraqitet në vijim, pranë bashkisë Mirditë.

Komentet dhe propozimet e takimeve publike do të reflektohen dhe do t'i bashkëlidhen dokumentit të planifikimit.

5. PLANI I VEPRIMIT PËR RISHIKIMIN E DOKUMENTIT TË PLANIFIKIMIT

Pas ndërmarrjes së nismës për rishikimin e PPV-së do të bëhet njoftimi i palëve të interesuara. Projekt-dokumenti i Nismës dhe Nisma e miratuar nga Kryetari do të botohen në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit (RKPT) dhe do të publikohen sipas mjeteve tradicionale të informimit.

Hapat më kryesorë janë si më poshtë:





















- Bashkia do të sigurojë një proces dialogu, bashkëpunimi dhe bashkërendimi, horizontal e vertikal, me çdo autoritet të planifikimit e palë të interesuar, përpara fillimit, gjatë procesit dhe gjatë rishikimit të PPV-së.
- Bashkia do të këshillohet me AKPT-në dhe palët e interesuara. Bashkia i vë në dijeni rregullisht të interesuarit për ecurinë e procesit, nëpërmjet botimeve në regjistër;
- Vendimi i Kryetarit të bashkisë, përgjegjës për marrjen e nismës, botohet në RKPT, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes së nismës, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar.
- Vendimi i Kryetarit për marrjen e nismës bëhet publik edhe në faqen zyrtare të bashkisë.
- Bashkërendimi dhe këshillimi kryhet përmes botimit të dokumenteve në regjistër, informimit të palëve të interesuara dhe publikut nëpërmjet një a më shumë mjeteve tradicionale të informimit dhe përmes organizimit të takimeve publike me ta.

6. PEZULLIMI I ZHVILLIMEVE NË TERRITORIN ADMINISTRATIV TË BASHKISË

Referuar nenit 33 të Ligjit Nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, bashkisë i rezervohet e drejta, që sipas rastit, me vendim të Kryetarit të bashkisë të pezullojë zhvillimet për të gjithë, ose një pjesë të territorit subjekt rishikimi.

Konkretisht, gjatë procesit të rishikimit të dokumentit të planifikimit të territorit të saj administrativ, bashkia **nuk propozon** të zbatohet instrumenti i pezullimit të zhvillimeve në territor.

Grupi i punës:

Nr.	Emër	Mbiemër	Roli në grup pune	Nënshkrimi
1.	Aleksandër	PICAKU	Kryetar,	
2.	Gjergj	PRENGA	Anëtar,	
3.	Administratorët sipas njësive		Anëtar,	
3.1	Gjin	MANDREJA	Anëtar,	
3.2	Armando	NDOJ	Anëtar,	
3.3	Vladimir	GJIKOLAJ	Anëtar,	
3.4	Gjin	PRENGA	Anëtar,	
3.5	Astrit	DEDAJ	Anëtar,	
3.6	Armond	NDRECA	Anëtar,	
3.7	Edmond	GJONAJ	Anëtar,	
4.	Genc	VLADI	Anëtar,	
5.	Besian	DEDAJ	Anëtar,	
6.	Vjollca	GJOKA	Anëtare,	
7.	Julian	VLASHI	Anëtar,	
8.	Frederik	VORFI	Anëtar,	
9.	Kastriot	BICA	Anëtar,	
10.	Aurel	ÇUPI	Anëtar,	
11.	Arjel	MARKU	Anëtar,	
12.	Dianisa	TRYCI	Anëtare,	
13.	Adenis	DEDAJ	Anëtar,	
14.	Zef	MARGJINI	Anëtar,	
15.	Lorena	GJERGJI	Anëtare,	